

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 37 të Ligjit për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 254/24), nenit 7 paragrafët (3) dhe (4) të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 152/19, 244/19, 275/19, 110/21, 123/22, 65/23 dhe 218/24), nenit 79 paragrafi 2 të Ligjit për duhanin, produktet e duhanit dhe produktet e ngjashme (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 98/19, 27/20 dhe 56/21), nenit 14 të Ligjit për verën (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 74/24 dhe 208/24) dhe nenit 59 të Ligjit për zooteknikë (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 87/23), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 4 shkurt 2025, miratoi

PROGRAM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI PËR VITIN 2025

I

Mjetet për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2025, në shumë të përgjithshme prej **6.271.000.000,00 denarë**, të siguruara në përputhje me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 254/24), pjesa 140.04, programi 2, nënprogrami 20, zëri 464 – transfere të ndryshme, do të shfrytëzohen sipas masave në vijim.

Nr. i masës	Masat për mbështetjen e të ardhurave të ekonomive bujqësore	Shuma totale e masës në denarë
1.	Pagesa direkte për prodhimtarinë bimore	2.500.000.000,00
2.	Pagesa direkte për prodhimtarinë blegtorale	500.000.000,00
Masat për mbështetje shtesë për zhvillimin e bujqësisë (ndihmë shtetërore në bujqësi)		
3.	Ndihmë për prime dhe sigurime	1.000.000,00
4.	Ndihmë për mbrojtjen e tokës bujqësore	1.000,00
5.	Ndihmë për kategori të veçanta të bartësve të ekonomive bujqësore	1.000,00
6.	Ndihmë në sektorin blegtoral	20.000.000,00
7.	Mbështetje financiare për magazinimin e grurit, elbit dhe orizit me origjinë vendore nga prodhimi i vitit 2025	1.000.000,00
8.	Ndihmë për mbështetjen e shpenzimeve për furnizim me karburante për mekanizimin bujqësor për ekonomitë bujqësore	400.000.000,00

9.	Ndihmë për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore në zona me mundësi të kufizuara për prodhim (ZMKP)	1.000,00
10.	Shpenzime materiale për zbatimin e kësaj programe	20.000.000,00
11.	Detyrime të prapambetura sipas masave nga Programet për mbështetje financiare në bujqësi për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024	2.828.997.000,00
	Gjithësej	6.271.000.000,00

II

Mjetet nga pjesa I, masa 1 e këtij programi, të destinuara për pagesa direkte për prodhimtarinë bimore, në shumë prej **2.500.000.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen sipas nënmasave në vijim:

Nr. i nënmasës	Emri i nënmasës
1.1.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të punueshme për të gjitha kulturat arave, bimët mjekësore, aromatike dhe erëza, si dhe për lulet
1.2.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.1 për prodhim të realizuar të grurit, elbit, lulediellit, rapit vajor dhe lëvozhgës së lulekuqes së opiumit.
1.3.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të punueshme për prodhimtarinë e perimeve në ambient të hapur dhe në serra
1.4.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.3 për prodhim nën kushte të kontrolluara të domateve, specave dhe kastravecëve.
1.5.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.3 për kultura perimore të dorëzuara në kapacitete përpunuese.
1.6.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të punueshme për mirëmbajtjen e plantacioneve ekzistuese frutore.
1.7.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.6 për fruta të dorëzuara në kapacitete përpunuese ose të blerës të regjistruar.
1.8.	Pagesa direkte për sipërfaqe bujqësore të punueshme për mirëmbajtjen e plantacioneve ekzistuese të hardhisë.
1.9.	Pagesa direkte për duhan oriental aromatik të papërpunuar, të kontraktuar dhe të shitur, nga prodhimi i vitit 2024.
1.10.	Pagesa direkte për fidanë të hardhisë ose të pemëve frutore të blera dhe të mbjella, me origjinë vendore, për ngritjen e plantacioneve të reja ose për rindërtimin e atyre ekzistuese
1.11.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 1.1 për prodhimin e materialit faror para-bazë, bazë dhe të gjeneratës së parë (C1) për grurë, elb, oriz, tritikale, bizele foragjere dhe duhan
1.12.	Pagesa direkte për prodhimin e materialit të certifikuar mbjellës për kultura perimore të llojeve: spec, domate dhe kastravec.

1.13.	Pagesa direkte për prodhimin e luleve në kushte <i>in vitro</i> .
1.14.	Pagesa direkte për sipërfaqe të dedikuara për plehërim të gjelbër ose djerrinë në kuadër të rotacionit të kulturave.
1.15.	Pagesa direkte për mirëmbajtjen e livadheve
1.16.	Pagesa direkte për ekonomi të vogla bujqësore, të përcaktuara sipas lartësisë së miratuar të mbështetjes për pagesa direkte për prodhimtarinë bimore dhe blegtorale, e cila nuk tejkalon 30.000 denarë .

III

Mjetet nga pjesa I, masa 2 e kësaj programe, të destinuara për pagesa direkte për prodhimtarinë blegtorale, në shumë prej **500.000.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen sipas nënmasave në vijim:

Nr. i nënmasës	Emri i nënmasës
2.1.	Pagesa direkte për krerë femra të gjedhit të identifikuar, më të vjetra se 18 muaj.
2.2.	Pagesa direkte për krerë femra të gjedhit të identifikuar, të moshës nga 6 deri në 18 muaj.
2.3.	Pagesa direkte për qumësht lope, dele dhe dhie të prodhuar dhe të dorëzuar.
2.4.	Pagesa direkte për krerë gjedhi të rritur dhe të shitur ose të therur në kapacitete thertore të regjistruara.
2.5.	Pagesa direkte për viç të përfituar nëpërmjet inseminimit artificial (I/A).
2.6.	Pagesa direkte për krerë dele të identifikuar, më të vjetra se 12 muaj.
2.7.	Pagesa direkte për krerë dhi të identifikuar, më të vjetra se 12 muaj.
2.8.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasat 2.1., 2.6. dhe 2.7. të kësaj programe, për rritje të numrit të deklaruar të krerëve në tufën bazë (gjedhë, dele dhe dhi), krahasuar me numrin për të cilin është miratuar mbështetje financiare në vitin kalendarik paraprak, për nënmasat 2.1., 2.8. dhe 2.10. nga pjesa III e Programit për mbështetje financiare në bujqësi për vitin 2024.
2.9.	Pagesa direkte për krerë femra riprodhuese – dosa.
2.10.	Pagesa direkte për derra të majmur të shitur ose të therur në kapacitete thertore të regjistruara
2.11.	Pagesa direkte për broilerë të rritur dhe të shitur ose të therur në kapacitete thertore të regjistruara.
2.12.	Pagesa direkte për pula vezore të amortizuara, të therura në kapacitete thertore të regjistruara
2.13.	Pagesa direkte për zogj njëditorë broilerë të prodhuar dhe të shitur dhe për zogj njëditorë femra nga hibride vezore.
2.14.	Pagesa direkte për familje bletësh të regjistruara dhe të dimëruara.

2.15.	Pagesa direkte shtesë nga nënmasa 2.14. për familje bletësh të përfshira në seleksion për prodhimin e mbretërëshave të bletëve.
2.16.	Pagesa direkte për analizë laboratorike të vetive fizike dhe kimike të mjaltit.

IV

Mjetet nga pjesa I, masa 3 e kësaj programe, në shumë prej **1.000.000,00 denarë**, të destinuara për ndihmë për prime dhe sigurime, do të shfrytëzohen në përputhje me nenin 98 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, me shumë maksimale të mbështetjes prej **150.000,00 denarë për ekonomi bujqësore**.

V

Mjetet nga pjesa I, masa 4 e kësaj programe, në shumë prej **1.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen për analizën e vetive fizike dhe kimike të tokës në ekonomitë bujqësore që kanë kryer analiza agro-kimike ose pedologjike gjatë vitit 2025, në masë prej **80% të shpenzimeve për analizë, pa tatimin mbi vlerën e shtuar**, por jo më shumë se **12.000,00 denarë për ekonomi bujqësore**.

VI

Mjetet nga pjesa I, masa 5 e kësaj programe, në shumë prej **1.000,00 denarë**, të destinuara për ndihmë për kategori të veçanta të bartësve të ekonomive bujqësore, do të shfrytëzohen në përputhje me nenin 102 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, si ndihmë shtesë që u jepet ekonomive bujqësore përfituese të pagesave direkte.

Ndihma shtesë u jepet kategorive të mëposhtme të bartësve të ekonomive bujqësore:

- **ndihmë shtesë prej 5%** për person juridik të regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore si ekonomi bujqësore, i themeluar nga bartësi ose anëtar i ekonomisë familjare bujqësore me tërë pasurinë bujqësore të ekonomisë familjare bujqësore, përveç objekteve për banim ose qëndrim të prodhuesve bujqësorë;
- **ndihmë shtesë prej 10%** për fermer të ri, bartës të ekonomisë familjare bujqësore; dhe
- **ndihmë shtesë prej 20%** për bartës të ekonomisë familjare bujqësore i cili është i regjistruar si ushtrues i veprimtarisë bujqësore në përputhje me Ligjin për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose është i regjistruar si fermer individual në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor.

VII

Një pjesë e mjeteve nga pjesa I, masa 6 e kësaj programe, në shumë prej **20.000.000,00 denarë**, të destinuara për ndihmë në sektorin blegtoral, janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve administrative për themelimin dhe mirëmbajtjen e librave amë, si dhe për shpenzimet e analizave të kryera për përcaktimin e cilësisë gjenetike ose rendimentit në blegtori, në përputhje me nenin 103 paragrafi (2) pikat 1 dhe 2 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural.

Përfitues të ndihmës për mbulimin e shpenzimeve administrative për themelimin dhe mirëmbajtjen e librave amë, në përputhje me nenin 103 paragrafi (2) pika 1 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, janë organizatat e njohura të mbarështuesve dhe organizatat e njohura të mbarështuesve të derrave hibridë, të regjistruara në Regjistrin e organizatave të njohura të mbarështuesve dhe organizatave të njohura të mbarështuesve të derrave hibridë, të cilin e mban Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në përputhje me Ligjin për zooteknikë (*).

Shuma e ndihmës nga paragrafi 2 i kësaj pjese është **80,00 denarë**, pa tatim mbi vlerën e shtuar, për çdo krerë kafshe të regjistruar në librin amë ose për çdo krerë të regjistruar në Regjistrin e derrave hibridë.

Shuma minimale e mjeteve të ndihmës nga paragrafi 2 i kësaj pjese, për çdo organizatë të njohur të mbarështuesve ose organizatë të njohur të mbarështuesve të derrave hibridë, është **200.000,00 denarë**, pa tatim mbi vlerën e shtuar.

Përfitues të ndihmës në blegtori, të destinuar për analiza të kryera për përcaktimin e cilësisë gjenetike ose rendimentit në blegtori, në përputhje me nenin 103 paragrafi (2) pika 2 të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, janë persona të tretë të regjistruar në Regjistrin e personave të tretë, të cilin e mban Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, në përputhje me Ligjin për zooteknikë (*), dhe të cilët kanë lidhur marrëveshje me organizatë të njohur të mbarështuesve ose me organizatë të njohur të mbarështuesve të derrave hibridë për zbatimin e aktiviteteve për testimin e produktivitetit ose të vlerës gjenetike të kafshëve ose të derrave hibridë, të parashikuara në programet e miratuara të mbarështimit.

Shuma e ndihmës nga paragrafi 5 i kësaj pjese është si vijon:

- për krerë kafshësh të llojit gjedhë, të regjistruara në librin amë, **5.000,00 denarë**, pa tatim mbi vlerën e shtuar;
- për krerë kafshësh të llojeve dele dhe dhi, të regjistruara në librin amë, **1.400,00 denarë**, pa tatim mbi vlerën e shtuar;
- për krerë kafshësh të llojit derra/derra hibridë, të regjistruara në librin amë ose në Regjistrin e derrave hibridë, **1.000,00 denarë**, pa tatim mbi vlerën e shtuar.

Për realizimin e pjesës I, masa 6 e kësaj programe, Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural shpall thirrje publike të hapura për paraqitjen e kërkesave për pagesën e mbështetjes financiare deri më **30 shtator 2025**.

VIII

Mjetet nga pjesa I, masa 7 e kësaj programe, në shumë prej **1.000.000,00 denarë**, janë të destinuara për mbështetje financiare për magazinimin e grurit, elbit dhe orizit me origjinë vendore, nga prodhimi i vitit 2025.

Përfitues të mjeteve nga pjesa I, masa 7 e kësaj programe, janë ekonomitë bujqësore të evidentuara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore, të cilat kanë sipërfaqe të deklaruara me grurë, elb dhe oriz në përputhje me nënmasën 1.1. të kësaj programe dhe e kanë dorëzuar grurin dhe elbin për magazinim te magazinuesit në periudhën nga **15 qershor** deri më **1 shtator 2025**, ndërsa orizin në periudhën nga **15 shtator** deri më **15 dhjetor 2025**, me përjashtim të ekonomive bujqësore që magazinojnë për nevoja vetjake.

IX

Mjetet nga pjesa I, masa 8 e kësaj programe, në shumë prej **400.000.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen në përputhje me nenin 98-v të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural për ndihmë në mbështetje të shpenzimeve për blerjen e karburantit për mekanizimin bujqësor në ekonomitë bujqësore.

Ndihma nga paragrafi 1 i kësaj pjese është në shumë prej **100% të shpenzimeve** të ekonomive bujqësore për blerjen e karburantit dizel për mekanizimin bujqësor, por jo më shumë se **100.000,00 denarë për ekonomi bujqësore**.

X

Mjetet nga pjesa I, masa 9 e kësaj programe, në shumë prej **1.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen në përputhje me nenin 77 paragrafi (8) të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural për ndihmë në ushtrimin e veprimtarisë bujqësore në zonat me mundësi të kufizuara prodhuese (ZMKP).

XI

Një pjesë e mjeteve nga pjesa I, masa 10 e kësaj programe, në shumë prej **17.000.000,00 denarë**, do të shfrytëzohen nga Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për mbulimin e shpenzimeve materiale për zbatimin e kësaj programe, dhe në veçanti për: shërbime për printimin e formularëve, materialeve informative dhe njoftimeve të nevojshme për zbatimin e kësaj programe; shërbime për printimin dhe dërgimin e njoftimeve te aplikantët;

blerje dhe shërbime për printimin e materialeve promovuese dhe përfaqësuese; shërbime për shkatërrimin e materialeve të dokumentuara; blerje të pajisjeve primare dhe sekondare me module mbrojtëse për rrjetin e Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (firewalls); shërbime për verifikimin e llogarive transaksionale të përfituesve të kësaj programe; blerje të karburantit dhe shpenzime udhëtimi për kryerjen e kontrolleve në terren, si dhe shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve; shërbime për zhvillimin, përshtatjen dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve softuerike për zbatimin e kësaj programe; shërbime nga ekspertë të jashtëm, duke përfshirë edhe auditimin. për zbatimin e kësaj programe; shërbime për sigurimin e imazheve satelitore të destinuara për kontrollin në terren; blerje të pajisjeve informatike dhe teknike të destinuara për zbatimin e kësaj programe, duke përfshirë pajisjet e nevojshme për kryerjen e kontrolleve në terren. Një pjesë e mjeteve nga pjesa I, masa 10 e kësaj programe, në shumë prej **3.000.000,00 denarë**, do të shfrytëzohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për blerjen e pajisjeve informatike dhe teknike të destinuara për zbatimin e kësaj programe.

XII

Mjetet nga pjesa I, masa 11 e kësaj programe, në shumë prej **2.828.997.000,00 denarë**, do të përdoren për pagesën e mjeteve financiare për detyrimet e mbetura nga masat e Programëve për mbështetje financiare në bujqësi për vitet **2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024**.

XIII

Përfitues të pagesave direkte nga pjesa I, masat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj programe, janë ekonomitë bujqësore të cilat kanë përmbushur të gjitha detyrimet financiare në përputhje me nenin 14-a të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural.

XIV

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masat 1 dhe 2 të kësaj programe është përcaktuar në nenin 4 pika 1, 2 dhe 3 të Rregullores për kriteret e hollësishme për pagesat direkte, përfituesit e mjeteve, shumën maksimale dhe mënyrën e pagesave direkte për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore).

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masën 3 të kësaj programe është **31 gusht 2025**.

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masën 4 të kësaj programe është **14 korrik 2025**.

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masën 5 të kësaj programe përcaktohet në nenin 4 pika 1, 2 dhe 3 të Rregullores dhe dorëzohen njëkohësisht me dorëzimin e kërkesave për nënmasat e përmendura në nenin 4 pika 1, 2 dhe 3 të Rregullores.

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masën 6 të kësaj programe është **31 tetor 2025**.

Afati për dorëzimin e kërkesave për pagesa direkte për masën 7 të kësaj programe për grurë dhe elb është **30 shtator 2025**, ndërsa për oriz **25 dhjetor 2025**.

XV

Pagesat direkte dhe pagesat direkte shtesë nga kjo programë do të kryhen jo më vonë se **30 qershor 2026**.

XVI

Kjo programë hyn në fuqi në ditën e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 50-866/8
4 shkurt 2025
Shkup

Zëvendëskryeministri i Qeverisë
së Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ljupčo Dimovski, n.p